

[ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

MARREVESHJE NDERMJET REPUBLIKES SE AUSTRIFE DHE REPUBLIKES SE SHQIPERISE PER NXITJEN DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE

REPUBLIKA E AUSTRIFE DHE REPUBLIKA E SHQIPERISE te quajtura me poshte «Pale Kontraktuese»,

NISUR NGA DESHIRA per te krijuar kushte te favorshme per nje bashkepunim ekonomik me te madh ndermjet Paleve Kontraktuese,

DUKE PASUR PARASYSH se nxitja dhe mbrojtja e investimeve forcojne gatishmerine per te bere investime te tilla dhe nepermjet tyre te mund te jepet nje kontribut i rendesishem per zhvillimin e marredhenieve ekonomike,

U MUARREN VESH SI VIJON:

Neni 1

Percaktime

Per qellimet e kesaj marreveshjeje:

- (1) Termi «Investim» perfshin te gjitha vlerat pasurore, dhe sidomos por jo vetem:
 - a) Pronesine mbi sendet e lujtshme e te palujtshme, si dhe te drejta te tjera reale (mbi sendet) si hipotekat, te drejta te mbajtjes, te drejta te pengut, te drejta te perdorimit dhe te drejta, te ngjashme me keto;
 - b) Te drejta mbi aksionet dhe mbi lloje te tjera te pjesemarrjeve ne ndermarrje;
 - c) Te drejta mbi para, te dhena per krijimin e nje vlere ekonomike, ose te drejta mbi nje sherbim qe ka nje vlere ekonomike;
 - d) Te drejta te autorit, te drejta te mbrojtjes se profesionit, si patenta shpikjeje, marka tregtare, mostra pune dhe modele, si dhe teknologji prodhimi, dije shkencore, emra tregtare dhe klientele;
 - e) Licenca te se drejtes publike per kerkimin, shfrytezimin dhe perfitimin e pasurive natyrore;
- (2) Termi «Investitor» ne lidhje me Palet Kontraktuese cileson:
 - a) Cdo person fizik, qe ka nenshtetesine e njeres Pale Kontraktuese dhe ben nje investim ne zona territoriale te Pales Kontraktuese tjeter;
 - b) Cdo person juridik ose shoqeri personash te se drejtes tregtare, krijuar ne perputhje me dispozitat ligjore te nje Pale Kontraktuese me seli ne zona territoriale te kesaj Pale Kontraktuese dhe ben nje investim ne zona territoriale te Pales Kontraktuese tjeter;
- (3) Termi «Fitim» cileson ato shuma qe sjell nje investim, dhe sidomos por jo vetem fitimet, interesat, shtesat e kapitalit, devidendet, pjeset e fitimit, detyrime per licensat dhe pagesa te tjera;
- (4) Termi «Shpronosim» cileson edhe nje shtetezim ose cdo mase tjeter me ndikim te njejte

Neni 2

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

(1) Cdo Pale Kontraktuese nxit sipas mundesive ne zona te saj territoriale investime nga investitorët e Pales Kontraktuese tjeter, lejon keto investime ne perputhje me dispozitat juridike te tyre dhe i trajton ato ne cdo rast ne menyre te drejte e te ndershme.

(2) Investimet sipas paragrafit 1 dhe fitimet e tyre, gezojne mbrojtjen e plote te kesaj Marreveshjeje. Njelloj vlen pa cenuar percaktimet e paragrafit 1, edhe ne rastin e nje rinvestimi te fitimeve edhe per fitimet e tyre. Zgjerimi, ndryshimi ose shnderrimi ligjor i nje investimi konsiderohet si nje investim i ri.

Neni 3

Trajtimi i investimeve

(1) Cdo Pale Kontraktuese i trajton investitorët e Pales Kontraktuese tjetër dhe investimet e tyre në mënyrë jo me pak të favorshme se sa investitorët e vetë dhe investimet e tyre, ose investitorët e shteteve të treta dhe investimet e tyre.

(2) Përcaktimet sipas paragrafit 1 nuk mund të shtrihen deri aty sa që ato të detyrojnë një Pale Kontraktuese, t'u japë investitorëve të Pales Kontraktuese tjetër dhe investimeve të tyre avantazhin aktual apo të ardhshëm, të një trajtimi, të një preference apo të një privilegji, i cili rrjedh nga:

- a) një bashkim doganor, një treg i perbashkët, një zonë e lirë tregtare ose nga anëtarësia në një bashkësi ekonomike;
- b) një marrëveshje nderkombetare, një marrëveshje ndërshtetërore ose një dispozitë ligjore e brendshme për çeshtje taksash.
- c) një rregullim për lehtësimin e transportit kufitar.

Neni 4

Zhdëmtimi

(1) Investimet e investitorëve të një Pale Kontraktuese lejohen të shpërndahen në zona territoriale të Pales Kontraktuese tjetër, vetëm për interesa publike në bazë të një procedure ligjore dhe përkundërt zhdëmtimit. Zhdëmtimi duhet t'i përgjigjet vlefës së investimit në kohën menjëherë para shpalljes publike të shpërndesimit faktik ose që rrezikohet. Zhdëmtimi duhet të bëjë pa vonësa të panevojshme dhe bashkë me interesat deri në castin e pagesës, me përçindjen e zakonshme të interesave bankare të atij shteti në zonat territoriale të cilat është bërë investimi. Zhdëmtimi duhet të kryhet në valutë të lirë të konvertueshme dhe të jetë lirish të transferueshme. Jo më vonë se deri në kohën e shpërndesimit duhet të bëjë kujdes në mënyrë të përshtatshme për përcaktimin dhe përballimin e zhdëmtimit.

(2) Kur një Pale Kontraktuese shpërndeson vlera pasurore të një shoqërie, e cila në zbatim të nenit 1, paragrafi 2, të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet si një shoqëri e saj, dhe tek e cila një investitor i Pales Kontraktuese tjetër ka të drejta aksionesh, atëherë ajo zbaton dispozitat e paragrafit 1 në mënyrë të atillë, që ketij investitor t'i sigurohet zhdëmtimi në masën e duhur.

(3) Investitorit i jepet e drejta të kontrollojë ligjshmerinë e shpërndesimit nëpërmjet organeve kompetente të Pales Kontraktuese, e cila ka bërë shpërndesimin.

(4) Investitorit i jepet e drejta të kontrollojë masën e zhdëmtimit dhe modalitetet e pagesave, ose nëpërmjet organeve kompetente të Pales Kontraktuese, e cila ka bërë shpërndesimin, ose nëpërmjet një arbitrazhi nderkombetar sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Dergesat e parave

(1) Cdo Pale Kontraktuese u siguron investitorëve të Pales Kontraktuese tjetër transferimin e lirë e pa vonësa të panevojshme në valutë të lirë të konvertueshme të pagesave, që kanë të bëjnë me një investim, sidomos por jo vetëm pagesat e:

- a) Kapitalit dhe shumave shtese të nevojshme për mbajtjen dhe zgjerimin e investimit.
- b) Shumave të caktuara për mbulimin e shpenzimeve në lidhje me administrimin e investimit.
- c) fitimeve;
- d) kthimit të huave;
- e) fitimit për rastet e likuidimit të plote ose të pjesshem ose të tjetërsimit të investimit;
- f) një zhdëmtimi sipas nenit 4, paragrafi 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Dergesat e parave sipas këtij neni, behen me kurset e shkëmbimit, që janë të vlefshme në ditën e transferimit të pagesave në zonat territoriale të shtetit kontraktues, nga i cili behet transferimi.

(3) Kurset e shkëmbimit do të përcaktohen nga sistemi bankar perkates në zonat territoriale të secilës Pale Kontraktuese. Komisionet bankare do të jenë të drejta dhe të përshtatshme.

Neni 6

E drejta e zevendesimit

Kur nje pale Kontraktuese ose nje institucion i autorizuar prej saj per kete qellim i ben pagesa investitorit te saj ne baze te nje garancie per nje investim ne zona territoriale te Pales Kontraktuese tjeter, atehere kjo Pale Kontraktuese tjeter pa cenuar te drejta e investitorit te Pales se pare Kontraktuese nga neni 8 i kesaj Marreveshjeje dhe te drejta e Pales se pare Kontraktuese nga neni 9 i kesaj Marreveshjeje e njej kalimin e te gjitha te drejtave apo pretendimeve te ketij investitori Pales se pare Kontraktuese sipas ligjit apo ne baze te nje transaksioni ligjor. Vec kesaj, Pala Kontraktuese tjeter njej futjen e Pales se pare Kontraktuese ne te gjitha keto te drejta apo pretendime, te cilat Pala Kontraktuese e permdur se pari ka te drejte t'i ushtroje ne te njejten mase si paraardhesi ligjor i saj. Per transferimin e pagesave qe u duhen bere Paleve Kontraktuese perkatese ne baze te te drejtave te mbartura vlejne ne menyre te pershtatshme neni 4 dhe neni 5 i kesaj Marreveshjeje.

Neni 7

Detyrime te tjera

(1) Ne rast se prej dispozitave ligjore te nje Pale Kontraktuese apo prej detyrimeve te se drejtes nderkombetare, qe ekzistojne ndermjet Paleve Kontraktuese krahas kesaj Marreveshjeje ose qe mund te viben ne te ardhmen, del nje rregull i pergjithshem ose i vecante nepermjet te cilit duhet t'u sigurohet investimeve te investitoreve te Pales Kontraktuese tjeter nje trajtim me i favorshem se sa ne kete Marreveshje, atehere ky rregull i paraprin kesaj Marreveshjeje ne ate mase, qe ai eshte me i favorshem.

(2) Cdo Pale Kontraktuese permbush cdo detyrim kontraktual qe ajo ka marre persiper ndaj nje investitori te Pales Kontraktuese tjeter ne lidhje me investimet e lejuara prej saj ne zonat territoriale te veta.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve nga investimet

(1) Kur nga nje investim linden mosmarreveshje ndermjet nje Pale Kontraktuese dhe nje investitori te Pales Kontraktuese tjeter, ato duhet te zgjidhen miqesisht ne ate mase qe eshte e mundur midis paleve.

(2) Ne rast se nje mosmarreveshje nuk mund te zgjidhet sipas paragrafit 1 brenda tre muajve pas nje njoftimi me shkrim ne lidhje me pretendimet e caktuara, atehere, me kerkesen e Pales Kontraktuese ose te investitorit te Pales Kontraktuese tjeter, mosmarreveshja i paraqitet per shqyrtim nje procedure pajtimi ose nje arbitrazhi te Qendres Nderkombetare per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve nga Investimet, e cila u krijua nepermjet Konventes per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve nga Investimet ndermjet shteteve dhe shtetasve te shteteve te tjere, e cila eshte lene hapur per oushkrimin me 18 mars 1965, ne Uashington. Nepermjet kesaj Marreveshjeje, ne rastin e nje arbitrazhi, cdo Pale Kontraktuese pranon paraparakisht ne menyre te paretvokueshme edhe pa egzistuar nje marreveshje arbitrazhi individual ndermjet Pales Kontraktuese dhe investitorit qe t'i parashtrihen mosmarreveshje te tilla Qendres dhe te njihet vendimi i arbitrazhit si detyrues. Kjo pranese permban heqjen dore nga kerkesa, se procedura e brendshme shtetore administrative apo gjyqesore eshte ezauruar.

(3) Vendimi i arbitrazhit eshte i formes se prere dhe detyrues. Ai ekzekutohet ne baze te juridiksionit te brendshem shtetor; cdo Pale Kontraktuese siguron njohjen dhe zbatimin e vendimit te arbitrazhit ne perputhje me dispozitat e tyre perkatese ligjore.

(4) Nje Pale Kontraktuese qe eshte pale ne mosmarreveshje, nuk mund ta perdor si argument kundershtimi ne asnje faze te procedures se pajtimit, te procedures se arbitrazhit apo te ekzekutimit te nje vendimi te arbitrazhit, faktin qe investitori, i cili perben palen tjeter ne mosmarreveshje, ka marre teresisht ose pjeserisht nje shdemptim per humbjet e tij ne baze te nje garancie.

Neni 9

Mosmarreveshjet ndermjet paleve kontraktuese

(1) Mosmarreveshjet ndermjet Paleve Kontraktuese mbi interpretimin ose aplikimin e kesaj marreveshjeje sa te jete e mundur duhet te zgjidhen nepermjet bisedimesh miqesore.

(2) Kur nje mosmarreveshje nuk zgjidhet brenda 6 muajve sipas paragrafit 1, atehere ajo i parashtrihet nje arbitrazhi me kerkesen e njeres prej Paleve Kontraktuese.

(3) Arbitrazhi formohet rast pas rasti, ne te cilen çdo Pale Kontraktuese cakton nje anetar, dhe te dy anetaret bien dakord per nje person te trete si kryetar. Anetaret duhet te caktohen brenda dy muajve, pasi njera Pale Kontraktuese ka njoftuar palen tjetere, se ajo deshiron t'ia parashtroje mosmarveshjen nje arbitrazhi, kurse brenda dy muajve te tjere duhet caktuar kryetari.

(4) Ne rast se afatet e permendura ne nenin 3 nuk permbahen, atehere ne mungese te nje marveshjeje tjetere, çdo Pale Kontraktuese mund t'i lutet presidentit te Gjykates Nderkombetare te beje emerimet e nevojshme. Ne rast se presidenti i Gjykates Nderkombetare ka shtetesine e njerres prej te dyja Paleve Kontraktuese, ose pengohet per ndonje arsye tjetere te ushtroje kete funksion, atehere zevendespresidenti, ose ne rast te pengeses se tij, anetari i Gjykates Nderkombetare me stazh me te gjate ne pune, mund te ftohet te beje emerimet, ne te njejtat kushte.

(5) Arbitrazhi vendos vete rregullin procedural te tij.

(6) Arbitrazhi vendos ne baze te kesaj Marveshjeje, si dhe ne baze te rregullave te pergjithshme te njohura te se drejtes nderkombetare. Vendoset me shumice votash: vendimi i arbitrazhit eshte i formes se prere dhe detyrues.

(7) Cdo Pale Kontraktuese perballon shpenzimet e anetarit te saj dhe te perfaqesise se saj ne procesin e arbitrazhit. Shpenzimet e kryetarit si dhe shpenzimet e tjera do te perballohen ne mase te njejte nga te dyja Palet Kontraktuese. Por gjykata ne vendimin e vet te arbitrazhit mund te vendose nje rregullim tjetere per shpenzimet.

Neni 10

Zbatimi i kesaj marveshjeje

Kjo Marveshje vlen per investime qe jane bere apo qe do te behen nga investitoret e nje Pale Kontraktuese ne perputhje me dispozitat ligjore te Paleve Kontraktuese tjetere ne zona territoriale te saj, si para, ashtu edhe pas hyrjes ne fuqi te kesaj Marveshjeje.

Neni 11

Hyrja ne fuqi dhe kohezgjatja

(1) Kjo Marveshje duhet te ratifikohet dhe hyn ne fuqi dite e pare te muajit te trete, e cila pason muajin, ne te cilin jane shkembyer instrumentat e ratifikimit.

(2) Marveshja qendron ne fuqi 10 vjet; mbas kalimit te ketij afati, ajo zgjatet per nje kohe te pacaktuar dhe cdo njera nga Palet Kontraktuese mund te denoncoje me shkrim ne rruge diplomatike, duke respektuar nje afat denoncimi prej dymbedhete muajsh.

(3) Per investime, te cilat jane bere deri ne kohen e shfuqizimit te kesaj marveshjeje, vlejne dispozitat e nenave 1 deri 10 te kesaj Marveshjeje edhe per dhjete vjet nga dita e shfuqizimit te marveshjes.

BERE ne vjen me 18 mars 1993 ne dy kopje origjinale secili ne gjuhen gjermanisht dhe shqip duke pasur te dy tekstet vlere te barabarte.

Per republiken e austrise:

MOCK

Per republiken e shqiperise:

SERREQI